



REPUBLIKA E KOSOVËS - ZYRA E PRESIDENTIT
REPUBLIC OF KOSOVO - OFFICE OF THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO - KANCELARIJA PREDSIEDNIKA

Në mbështetje të nenit 34 të Ligjit Ligjin Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë (GZ, Nr. 8 /11 mars 2019), dhe të nenit 9 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës datë: 21.08.2020). Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës shpall:

KONKURS

Për Zyrtar të Lartë për Agjendë në Departamentin e Protokollit në Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës.

PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I PUNËS

1. Nën mbikëqyrjen e Drejtorit të Departamentit të Protokollit, dhe në koordinim të ngushtë me asistentin personal të Presidentit dhe këshilltarët e Presidentit përkujdeset dhe është përgjegjës për përpilimin e agjendës së përditshme të Presidentit.
2. Në konsultim me Drejtorin e Departamentit dhe Asistentin e Presidentit është përgjegjës për njoftimin e këshilltarët e Presidentit dhe Departamentin e Komunikimit me agjendën veçanërisht për takimet në të cilat kërkohet prezenca e tyre.
3. Përpilon dhe i dërgon tek palët njoftimet për konfirmimin e takimeve si dhe për pamundësinë e pjesëmarrjes së Presidentit në aktivitete të caktuara.
4. Merret me realizimin e agjendës së Presidentit në zyrë dhe jashtë zyrës.
5. Kryen edhe detyra të tjera protokollare të nevojshme për funksionimin e tërësishëm të Departamenti të Protokollit.

KËRKESA E PËRGJITHSHME PËR PRANIMIN E ZYRTARIT PUBLIKË

1. Kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publikë janë:
 - 1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
 - 1.2. të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
 - 1.3. të zotërojë njëzëri nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
 - 1.4. të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
 - 1.5. të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
 - 1.6. të kenë nivelin e arsimit dhe përvojën e punës të kërkuar për pozitën përkatëse.

**NJOHURITË, AFTËSIT DHE CILËSIT QË DUHET TI PLOTËSOJNË
KANDIDATËT PËR TU PËRZGJEDHUR PËR ZYRTARIN E LARTË PËR
AGJENDË JANË:**

- përgatitja Universitare;
- njohurit në fushën e protokollit shtetëror;
- aftësi të shkëlqyeshme organizative, për të trajtuar në mënyrë të duhur informatat në besim, për të punuar me efikasitet nën presion kohor;
- aftësi komunikimi të zhvilluara mirë;
- të paktën 2 vite përvojë pune dhe prej tyre së paku 1 vit në pozitë të ngjashme në institucionet/organizatat vendore ose institucionet ndërkombëtare të ndërlidhura me lëmin e kësaj detyre.
- aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur, si dhe në një mjedis ekipor;
- njohuri të mira të gjuhës shqipe;
- njohja e gjuhës angleze në të folur dhe shkruar është përparësi.

**DOKUMENTET QË DUHET TË DORËZOHEN SI PJESË E APLIKACIONIT
DHE MËNYRËN E DORËZIMIT TË TYRE**

Kandidatët për Zyrar të Lartë për Agjendë, duhet të dorëzojnë këto dokumente.

- ✓ CV-në;
- ✓ letër motivimin;
- ✓ dokumentacionet e parapara në kushtet e punësimit (dëshmitë e kualifikimit profesional, përvojës së punës);
- ✓ kopjen e Letërnjoftimit
- ✓ të ketë zotësi të plotë për të vepruar, e cila merret ne Qendrat e mirëqenies sociale;
- ✓ të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse – certifikate shëndetësore për punësim
- ✓ të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje – nga Gjykata Kompetente.

Aplikacioni shkarkohet nga Ueb faqja e Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës dhe dorëzohet në Njësinë e Personelit, ose nëpërmes emailit zyrtar:

mahije.haradinaj@president-ksgov.net. sebahate.halili@president-ksgov.net.

Tel: 038 211973, 038 211662.

Konkursi është i hapur nga data 30.10.2020 gjer me datë 19.11.2020.

Pranimi i aplikacioneve fillon me datë 05.11.2020 çdo ditë pune nga ora 8:00-16:00 dhe përfundon me datë 19.11.2020 në orën 16:00.

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligjin përkatës;

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.